



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve**

Data: 15.05.2023

Nr: 114

Ora: 13:30

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS NR. 30, DATË 12.05.2023 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË  
ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 15.05.2023, me pjesëmarrjen e:

|                |                |   |                |
|----------------|----------------|---|----------------|
| <b>Elvin</b>   | <b>LAKO</b>    | - | <b>Relator</b> |
| <b>Elvis</b>   | <b>ÇEFA</b>    | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ilirjan</b> | <b>RUSMALI</b> | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Koli</b>    | <b>BELE</b>    | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ledio</b>   | <b>BRAHO</b>   | - | <b>Anëtar</b>  |

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**PALË E INTERESUAR:** z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë e Brendshme

**OBJEKT:** Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ ndaj z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë e Brendshme; zj. Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj.



Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; zj. Edlira Zyfi, person përgjegjës pranë Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve; z. Gazmend Turdiu, person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

**BAZË LIGJORE:**

Neni 19, pika 1, shkronja “c” dhe neni 21, pika 1, shkronja “dh” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

**Rrethanat e çështjes:**

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë denoncime për publikimin e postimeve me përmbajtje elektorale nga institucionet publike, si ministri dhe ministra, për të cilat pretendohet nga denoncuesi se postimet me përmbajtje partiake në faqet zyrtare të tyre në rrjetin social “Facebook” përbëjnë përdorim të burimeve publike. Denoncimet janë marrë nëpërmjet provave link dhe materialeve fotografike, të administruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet raportit të KRIIK, të datës 2 Maj 2023 “Për gjetjet dhe rekomandimet për javën 21 Prill- 27 Prill 2023”, për postimin/ripostimin me slogane në mbështetje të subjektit zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për të cilat pretendohet se janë shkelur parashikimet e nenit 91 të Kodit Zgjedhor.
2. Mbi këtë bazë, Komisioneri ka nisur hetimin administrativ ndaj personave përgjegjës në pesë ministri, përkatësisht Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Shtetit për Standardet e Shërbimeve, si dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe ka konstatuar me anë të provave dhe fakteve të administruara, shkeljen e nenit 91 të Kodit Zgjedhor.
3. Me anë të vendimit nr. 490, datë 11.05.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka urdhëruar fshirjen e menjëhershme nga faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook”, të secilës

Ministri, të çdo postimi apo ripostimi në të cilat janë përdorur hashtag me përmbajtje elektorale.

4. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioneri ka vënë në lëvizje KAS-in me anë të një kërkesë, duke kërkuar marrjen e masës administrative me gjobë ndaj personave përgjegjës përkatës të ministrive, në masën 3 000 (tre mijë) lekë, ndaj z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë e Brendshme; zj. Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; zj. Edlira Zyfi, person përgjegjës pranë Ministrit të Shtetit për Standardet e Shërbimeve; z. Gazmend Turdiu, person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. sikurse parashikohet nga dispozita e nenit 171 pika 1 e Kodit Zgjedhor.
5. KAS-i caktoi me short z. Elvin Lako relator për shqyrtimin e kërkesës nr. 30, datë 12.05.2023 të Komisionerit dhe në seancën paraprake vendosi pranimin për shqyrtim të kërkesës, duke e caktuar seancën e shqyrtimit më 15.05.2023, ora 13:30.
6. Seanca e datës 15.05.2023 u zhvillua me praninë e Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së, si përfaqësues i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të specialistëve të administratës së KQZ-së.
7. Gjatë seancës së shqyrtimit mori pjesë z. Enea Hoti, person përgjegjës në Ministrinë Brendshme. Pala, në cilësinë e përfaqësuesit të Ministrisë së Brendshme pretendoi se nga ana e tyre është konstatuar shkelja në lidhje me postimin me përmbajtje në kundërshtim me ligjin, e ka riparuar dëmin pasi ka marrë masa direkte për heqjen e postimit, duke e fshirë materialin. Z. Hoti shprehu se aktiviteti, objekt ripostimi ishte i organizuar nga Ministria e Brendshme, si dhe nuk ka pasur mundësi të ndryshojë përmbajtjen e postimit në fjalë.
8. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën nr. 30, datë 12.05.2023 të Komisionerit;
  - Vendimin e Komisionerit nr. 490, datë 11.05.2023 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimit nr. 368 ID, nga Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të

Konsoliduara ndaj Ministrave dhe personave përgjegjës në disa ministri, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

- Denoncimin me nr. 368 ID të KRIIK, bashkëlidhur provat materiale fotografike.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve përfundimtare,

#### **KAS-i konstaton:**

1. Hetimi administrativ i zhvilluar nga Komisioneri për denoncimin nr. 368 ID ka mundur të provojë kryerjen e postimeve/ripostimeve në faqet zyrtare “Facebook” të institucioneve publike objekt denoncimi. Shkeljet e konstatuara kanë lidhje me përdorimin e hashtag (#) dhe sloganeve me përmbajtje politike/elektorale.
2. Komisioneri ka vlerësuar se “...vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “Facebook” apo çdo mjeti tjetër komunikimi elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo nëpërmjet ripostimit të postimeve me hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike”.
3. Shkeljet e konstatuara janë hetuar dhe provuar saktë nga ana e Komisionerit dhe KAS-i i gjen propozimet e Komisionerit për marrjen e masave administrative për personat përgjegjës të këtyre ministrive, si institucione publike, të mbështetura në ligj dhe në prova.
4. Gjatë seancës së shqyrtimit, pala e interesuar z. Enea Hoti qartësoi se ripostimi ishte një gabim material, si dhe është fshirë menjëherë postimi pasi është konstatuar shkelja administrative. KAS-i konstatoi se për rastin e denoncuar, hetimi administrativ provon se mungon dashja në kryerjen e shkeljes. Personi përgjegjës ka fshirë menjëherë ripostimin, sapo ka konstatuar se binte ndesh me rregullat e përcaktuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në këto kushte, KAS-i e gjen me vend që të heqë dorë nga sanksionimi i z. Enea Hoti, për katër ditët që ripostimi ka qëndruar i afishuar në faqen e “Facebook” të Ministrisë së Brendshme.

5. Kërkesa e Komisionerit për vendosjen e sanksionit administrativ lidhur me postimin e kryer nga ministritë e tjera është bërë për shkak se *“...Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shtetit për Standartet dhe Shërbimet, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, objekt denoncimi, kanë bërë një sërë ripostimesh të cilat përmbajnë hashtag # dhe slogane me karakter politik/elektoral, duke keqpërdorur këto llogari institucionale që përbëjnë burim publik. Për pasojë vlerësohet se jemi përpara një shkelje administrative të Kodit Zgjedhor, nga këto institucionë publike pasi vërehet qartazi promovimi i subjekteve zgjedhore, në zgjedhjet vendore të 14 Maj 2023”*. Veprimtaritë e denoncuara, episode ripostimi në “Facebook” nga faqet zyrtare të ministrive të cituara shprehin mbështetje ndaj një subjekti zgjedhor, me sloganet e njohura të partisë politike “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
6. Faqet zyrtare të institucioneve publike në rrjetet e ndryshme sociale (facebook, tëitter, instagram etj.) bëjnë pjesë në kategorinë “asete”, në kuptim të pikës 2 të nenit 91 të Kodit Zgjedhor, pra ato janë “burime” të institucionit në kuptim të kësaj dispozite. Kjo do të thotë se faqet zyrtare të ministrive në rrjetet e ndryshme sociale, nuk mund të përdoren ose të vihet në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje.
7. Pika 1 e nenit 91 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“...nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve **NË ZGJEDHJE** burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administrues të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Ky ndalim është konfirmuar edhe nga vendimi i Rregullatorit nr. 9, datë 24.12.2020 në përkufizimin e “veprimtarive të ndaluara” ku ndalon *“vënien në dispozicion të asetëve të luajtshme dhe të paluajtshme ... për qëllime zgjedhore”*.
8. Pika 1 e nenit 171 të Kodit Zgjedhor përcakton sanksionin për shkeljet e kryera *“nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga PERSONA TË NGARKUAR ME DETYRA, sipas këtij Kodi”*. Personat e ngarkuar me detyra formojnë një listë personash/institucioneve të cilët janë ngarkuar me detyra nominalisht nga Kodi Zgjedhor. Të tillë janë p.sh. vëzhguesit a

perfaqësuesit e subjekteve zgjedhore në KQZ (për etikën e punës e të komunikimit), Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (për dërgimin e të dhënave nga regjistri për ndarjen e zonave të administrimit zgjedhor, për listën e zgjedhësve etj), zyra e gjendjes civile dhe kryetari i bashkisë (për listën e zgjedhësve), kryetari i bashkisë (për caktimi e qendrave të votimit), Ministri që ka në varësi shërbimin e gjendjes civile (për nxjerrjen e urdhërave për listat dhe zonant e qendrave të votimit) etj. Fakti se ata dhe detyrat e tyre përcaktohen nga Kodi do të thotë se lista e tyre është e fundme dhe nuk mund të shtohet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor. Personat përgjegjës në ministritë e përmendura bëjnë pjesë në listën e “*personave të ngarkuar me detyra, sipas Kodit*”. Sanksioni për ta do të vendoset sipas pikës 1, të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 21, pika 1, shkronja ‘dh’, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

#### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksioneve administrative.
2. Vendosjen e sanksionit administrativ në masën 3 000 (tre mijë) Lekë ndaj zj. Joana Duro, person përgjegjës në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; zj. Risena Xhaja, person përgjegjës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në masën 3 000 (tre mijë) Lekë; zj. Edlira Zyfi, person përgjegjës në Ministrinë e Shtetit për Standardet e Shërbimeve; z. Gazmend Turdiu,

person përgjegjës në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, bazuar në nenin 171, pika 1, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

3. Rrëzimin e kërkesës së Komisionerit për vendosjen e sanksionit për pjesën tjetër.
4. Ngarkohet administrata e KQZ-së me njoftimin e këtij vendimi palëve në mungesë dhe me zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Bazuar në pikën 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.

U shpall sot më datë 15.05.2023.

|                |                |   |                |
|----------------|----------------|---|----------------|
| <b>Elvin</b>   | <b>LAKO</b>    | - | <b>Relator</b> |
| <b>Elvis</b>   | <b>ÇEFA</b>    | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ilirjan</b> | <b>RUSMALI</b> | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Ledio</b>   | <b>BRAHO</b>   | - | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Koli</b>    | <b>BELE</b>    | - | <b>Anëtar</b>  |